



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY  
"ISA BOLETINI"  
MITROVICË**

**Rektori**

Prof. dr. Alush Musaj

Nr. Prot. 1622 Dt 26.07.2023

Në bazë të nenit 29 të Stautit të Universitetit "Isa Boletini", në Mitrovicë, dhe nenit 33 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, në koordinim me sekretarin e përgjithshëm merr këtë:

**V E N D I M**

**Për shfrytëzimin e pushimit vjetor kolektiv për personelin akademik dhe administrativ të Universitetit "Isa Boletini", Mitrovicë për vitin 2023**

1. Pushimi vjetor për të gjithë personelin akademik dhe administrativ të Universitetit "Isa Boletini", në Mitrovicë, do të shfrytëzohet nga datat 31.07.2023 deri më 25.08.2023 (20 ditë pune).
2. Kthimi në punë nga pushimi vjetor do të bëhet me datë 28.08.2023.
3. Përjashtim nga paragrafi 1 i këtij vendimi do të bëhet për personelin administrativ të cilëve, sipas ligjit në fuqi, iu takojnë ditë të pushimit vjetor më pak se pushimi i përcaktuar me vendim.
4. Personeli që i takon kategorisë si në paragrafin 3 të këtij vendimi, pas shfrytëzimit të ditëve të pushimit vjetor, do të rikthehet në punë.
5. Personeli administrativ që pjesërisht e ka shfrytëzuar pushimin vjetor të vitit 2023, pjesën e mbetur të pushimit mund ta shfrytëzoj vetëm për ditët që i takojnë sipas ligjit.
6. Në bazë të nenit 33, paragrafi 1 të Ligjit të punës, pushimin vjetor për punëtorët e arsimit, duke përfshirë këtu edhe punëtorët e administratës shfrytëzohet në kohën e pushimeve verore të shkollave dhe mund të zgjasë deri sa të zgjasë pushimi nëpër institucionet edukativo-arsimore. Në pamundësi për të shfrytëzuar pushimin vjetor në periudhën e pushimeve verore, për punëtorët e administratës, pjesa tjetër e pushimit vjetor të pashfrytëzuar duhet të shfrytëzohet, në një kohë të përshtatshme në pajtim me menaxherin e drejtpërdrejtë, jo më vonë se 30 qershor të vitit të ardhshëm kalendarik.
7. Dekanët dhe sekretarët e njësive akademike do të kujdesen që gjatë pushimit vjetor kolektiv do të kryhen shërbime për studentët, si raste urgjente, në ditët e punës nga ora 10:00-12:00.
8. Zyra e financave, e prokurimit dhe zyra e diplomave, si dhe të gjitha zyrat e AQ, gjatë periudhës së pushimit vjetor kolektiv, do të kryejnë vetëm shërbimet esenciale. Për orët e punës si staf esencial, nëpunësit dhe mbikëqyrësit e tyre obligohen që të mbajnë evidencë.
9. Personeli administrativ i angazhuar si në paragrafin 8 të këtij vendimi, do të shfrytëzojnë pushimin vjetor në një kohë të përshtatshme n

10. Sekretarët e njësive akademike përkatëse, janë të obliguar që për secilin nënpunës administrativ të lëshojnë vendim individual për periudhën e shfrytëzimit të pushimit vjetor për vitin 2023.
11. Menaxheri i personelit, obligohet që për secilin nënpunës administrativ të AQ të lëshojë vendim individual për periudhën e shfrytëzimit të pushimit vjetor për vitin 2023.
12. Ky vendim hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit.

Vendimi t'i dërgohet:

1. Arkivit të UIBM;
2. Menaxhmentit të UIBM;
3. Sekretarit të përgjithshëm;
4. Dekanëve të njësive akademike;
5. Sekretarëve të njësive akademike;
6. Drejtorëve të AQ;
7. Zyrës së personelit;
8. Publikohet në web faqen e UIBM – [ëë. umib. Net](http://ee.umib.net)

Prof. dr. Alush Musaj  
Rektor

